

Shqiptohen masat e vërejtjes ndaj 1TV dhe TV KOMPANI 21-M

Shkup, 05.12.2018. – Në bazë të mbikëqyrjes së rregullt programore dhe administrative të programit të 1TV dhe mosrespektimit të konstatuar të obligimeve për mbrojtjen e publikut minoren, publikimit të impresumit dhe për rregullat e emetimit të komunikimeve audiovizuele komerciale, Agjencia shqiptoi masat e vërejtjes .

Për mosrespektimin e obligimit të informatave që duhet të jenë në dispozicion të shfrytëzuesve Agjencia shqipton masën e vërejtjes ndaj TV KOMPANI 21-M. Të dy radiodifuzerëve u është dhënë afat kohor prej 30 ditëve që të harmonizojnë punën e tyre me dispozitat e Ligjit për shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele.

Masat e shqiptuara mund të merren në këto linke:

1 TV – (neni 50 paragrafi 3 nga LSHMAA) – 04.12.2018

1 TV – (neni 14 nga LM) – 04.12.2018

1 TV – (neni 53 paragrafi 2 nga LSHMAA) – 04.12.2018

TV KOMPANI 21-M – (neni 51 paragrafi 1 nga LSHMAA) – 04.12.2018